



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 22.05.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtines, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vodosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 18.05.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Vlera" për aktivitetin: "Deratizimi i bodrumeve dhe garazheve publike dhe deratizimi i kanalizimit në qytetein e Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: **616 -18-1347-211** nxjerr:

VENDIM

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik “**Vlera**” e datës 18.05.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit “ Deratizimi i bodrumeve dhe garazheve publike dhe deratizimi i kanalizimit në qytetein e Prishtinës” me Nr.616 18 1347 211,Nr. Brendshëm 616 18 036 211 kundër Njoftimit për dhënje të kontratës te AK -së, të datës 14.05.2018, te publikuar ne web-faqe te KRPP-së.
 2. Vërtetohet Njoftimi për dhënje të kontratës i publikuar me datë: 14.05.2018;
 3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin.
 4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elekronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyvetim

Operatori Ekonomik “**Vlera**” me datë 18.05.2018 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Deratizimi i bodrumeve dhe garazheve publike dhe deratizimi i kanalizimit në qytetein e Prishtinës” me Nr.616 18 1347 211 Nr. Brendshëm 616 18 036 211”.

Autoriteti Kontraktues, me datë 22.05.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka ka konstatuar si vijon:

1. Edhepse nuk është paqitit asnjë pretendim konkret lidhur me pretendimin se jeni oferta e parë ju sqarojmë që së pari oferta duhet te jetë e përgjegjshme;

2. Lidhur me pretenndimin se arsyet e eliminimit janë të pa bazuara ju sqarojmë se tenderi juaj është shqyrtuar me kujdes dhe se arsyet e eliminimit janë të qëndrueshme bazuar në faktet si vijon:

-Ju në listën e kontratave të realizuara keni paraqitur edhe një kontratë të lidhur me OE-ik "Viva Fresh", sipas konfirmimit të të cilit vlera mujore e shërbimeve do të jetë afersisht 10,000.00 euro në muaj dhe kjo është kontratë afatgjate prej një viti, ndërsa ju keni dorëzuar si dëshmi fatura për kinse realizimin e shërbimeve për vitin 2017, që edhepse nuk mund të jenë dëshmi fatura rezultojnë në pa pajtueshmëri kohore nme kontratën e paraqitur, e cila nuk është e përfunduar, pasiqë veç sa ka filluar implementimi i saj. Kontratat e paraqitura në listë për vitet paraprake edhe nëse konsiderohen si të përfunduara nuk e plotësojnë as për se afërmë kerkësën tonë; dhe

-Është konstatuar poashtu se ju nuk keni dorëzuar dëshmitë e kërkua e stafin, respektivisht për inspektoët sanitari, por për radiolog e që nuk kanë të bëjnë me kërkësat e tenderit.

Bazuar në sqarimet paraprake zyrtari përgjegjës i prokurimit konsideron se kerkesa juaj është e pabazuar dhe se në procesin e vlerësimit nuk është bërë asnjë shkelje ligjore siqë pretendoni ju në pikën 8 të kerkësës dhe sipas kësaj ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit